



**BANKING AND PAYMENTS AUTHORITY OF KOSOVO
AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE TE KOSOVES
BANKARSKI I PLATNI AUTORITET KOSOVA**

Letër Këshilluese 2006-1

11 Maj 2006

Aktivitetet Financiare Jashtë-burimore

DREJTUAR TË GJITHË DREJTORËVE TË PËRGJITHSHËM TË
INSTITUCIONEVE FINANCIARE TË KOSOVËS

Bankat dhe institucionet financiare në Kosovë në mënyrë të rritur kanë shfrytëzuar shërbimet nga “burimet e jashtëm” për shumë funksione financiare. Këtu përfshihen shërbimet e kontabilitetit, listave të pagava, lejimit të kredive dhe mbledhjes së tyre, procesit të debit/kredit kartelave, dhe shërbimet e TI për të gjitha hapësirat e aktivitetit financiar. Në disa vende, edhe funksioni i revizionit të brendshëm është kryer nga “burimet e jashtme”.

BPK dëshiron ta bëjë të qartë se burimi i jashtëm nuk e liron institucionin nga rreziku i përgjegjësisë menaxhuese për aktivitet jashtë burimore.

Komiteti i Bazelit për Mbikqyrjen Bankare ka lëshuar një dokument këshillues për këtë çështje, dhe nga Institucionet Financiare Kosovare pritet që të mbështeten në parimet e këtij dokumenti. Këtu përfshihen të dhënat vijuese:

- Bordi Drejtues i Institucioneve financiare i dhe menaxhimi i lartë duhet të krijojnë dhe të aprovojnë politikat e bazuara në rrezikun e dedikuara me proceset jashtë burimore. Bordi Drejtues mban përgjegjësinë për politikën e burimit të jashtme dhe përgjegjësitë e lidhura me aktivitet e ndërmarra nën këtë politikë.
- Institucionet financiare duhet të themelojnë një program krahasues të rrezikut nga burimet e jashtme për të adresuar aktivitet jashtë burimore dhe marrëdhënien me siguresin e shërbimeve. Ky program duhet të sigurojë një kornizë menaxhuese për të identifikuar, matur, monitoruar si dhe kontrolluar rrezikun e lidhur me burimet e jashtme.
- Institucioni financiar duhet të sigurojë që marrëveshjet me burimet e jashtme të mos zvogëlojnë aftësitë e tyre për të përmbushur obligimet ndaj klientëve si dhe BPK-së, por edhe të mos pengojnë mbikëqyrjen efektive nga ana e BPK-së.

33 Garibaldi street Prishtina Kosovo UNMIK
Phone: +381 38 222 055 Fax: +381 38 243 763 web:www.bpk-kos.org

- Institucioni financiar duhet të udhëheq një kujdes të nevojshëm “due diligence” me rastin e zgjedhjes së ofrueseve të jashtëm të shërbimeve.
- Marrëdhëniet jashtë burimore duhet të drejtohen me kontrata të shkruara të cilat qartë e përshkruajnë aspektin e gjithë materialit të kontratës me burimin e jashtëm, duke përfshirë të drejtat, përgjegjësitë dhe pritjet nga të gjitha palët.
- Institucionet financiare dhe ofruesit e tyre të shërbimeve duhet të themelojnë dhe të kenë planet e rastësisë, duke përfshirë planin e rimëkëmbjes pas katastrofave dhe testimin kohë pas kohe të të gjitha pajisjeve mbështetëse.
- Institucioni financiar duhet të ndërmarrë hapa të duhur që ofruesit e shërbimeve të mbrojnë informacionet sekrete të institucioneve dhe klientëve nga zbulimi me qëllim ose i pa qëllimit i informacionit nga personat e pa autorizuar.

Dokumenti i plotë këshillues për parimet e sipër përmendura mund të gjinden në faqen e internetit të Komitetit të Bazelit: <http://www.bis.org/publ/joint09.pdf>. Shkalla e formalitetit për këtë program, sigurisht, që duhet të përcaktohet nga përbërja dhe ndërlikimet e burimit të jashtëm në ndonjë institucion financiar.

Ju rikujtohet juve që aktivitetet e kryera nga ofruesit e jashtëm të shërbimeve në emër të Institucioneve financiare janë çështje e kërkesave të njëjta rregullative si vetë Institucionet Financiare. BPK –ja ka autoritet të mbikëqyrë të gjitha këto aktivitete dhe të dhënat e Institucioneve financiare, pa marrë parasysh se janë të kryera ose të mirëmbajtura nga pala e tretë në hapësirat e tyre të punës apo jashtë tyre.